




RAPORTI EVROPIAN I AKSIDENTIT



Aksidentet i komunikacionit-Çka duhet të bëni?

• Nëse dikush ka humbur jetën ose është lënduar apo është shkaktuar dëm i madh material:

Të njoftohet institucioni shëndetësor dhe Policia e Kosovës, të qëndrojnë në vendin e aksidentit të komunikacionit, por që mund të largohet për kohësisht vetëm për t'u ofruar ndihmë personave të lënduar në aksident të komunikacionit, të ndërmarë krejt çka mundet që të mënjanojnë rreziqet e reja, që mund të krijohen në vendin e aksidentit të komunikacionit, të mundësohet qarkullim normal i komunikacionit, të ndërmerren të gjitha masat që mos të ndryshohet gjendja në vendin e aksidentit dhe të ruhen gjurmët ekzistuese. Të ndizen të gjithë treguesit e kahut si dhe të vendoset trekëndëshi i sigurisë (së paku 50 m nga vendi i aksidentit).

• Nëse është shkaktuar dëm i vogël material:

Që menjëherë të largohen mjetet nga rruga, të mundësohet zhvillimi i papenguar i komunikacionit, të plotësohet dhe të nënshkruhet "Informacionin evropian i aksidentit" dhe në të njëjtën kohë të shkëmbehen të dhënat personale dhe të dhënat për mjet (neni 206 i Ligjit mbi Sigurinë e Komunikacionit Rrugor nr. 02/L-70).

Shoferët, nuk guxojnë të lëshojnë vendin e aksidentit të komunikacionit derisa të mos e kenë plotësuar dhe nënshkruar "Informacionin evropian" apo në ndonjë mënyrë tjetër derisa të shkëmbejnë të dhënat personale dhe të dhënat për mjetet. Ju rekomandojmë që pozitat e mjetit dhe vendin e aksidentit të maten dhe të fotografohen drejtpërdrejt nga një distance e afërt dhe e largët (dëmtimin e mjeteve, gjurmët e frenimit, bartjes dhe mbeturinat të rëna në rrugë...) dhe që gjurmët e rëndësishme –pozita e rrotave të shënohen me shumës. Raporti mbi aksidentin e komunikacionit shërben për ta konstatuar gjendjen faktike dhe nuk do të thotë së në mes palëve është arrite marrëveshja e fajësisë lidhur me aksidentin, si dhe me nënshkrim pranohet fajësia. Nëse përshkrimi i aksidentit në raportin evropian që nuk mjafton të evidentohen të gjitha elementet e duhura, nëse është e nevojshme mund të evidentohen në një fletë të veçantë vazhduese.

Nëse pjesëmarrësi tjetër në aksident ju refuzon t'i japë të dhënat personale, të dhënat për mjetin ose i njëjti e lëshon vendin e aksidentit, në rastin e mos përputhjeve të mendimeve në lidhje me fajësinë, në rast të aksidentit me mjetin e paregjistruar, me njëjtin me regjistrim të huaj, shofer të dehur, drejtim pa patentë shofer dhe të tjera-ju rekomandojmë që lidhur me aksidentin ta lajmëroni policinë, e cila do të vijë në vendin e aksidentit (neni 212 i Ligjit për siguri në komunikacion rrugor).

Si plotësohet 'Raporti mbi aksidentin e komunikacionit'?

• Në vendin e aksidentit të komunikacionit

1. Përdorni vetëm një formë të raportit për 2 mjete që janë përfshirë në një aksident komunikacioni (gjegjësisht 2 forma për 3 mjete, etj); Nuk është me rëndësi i cilit pjesëmarrës është formulari apo cili pjesëmarrës i aksidentit e plotëson, gjatë plotësimit është e nevojshme të përdoret stilolapsi, kopja duhet të jetë e lexueshme.

2. Gjatë plotësimit të raportit, ju lutem vini re si në vijim:

-shikoni me vëmendje para se të përgjigjeni në pyetje

a) nën pikën 6 dhe 8, përshkruani nga dokumentacioni juaj për sigurimin (polica e sigurimit ose kartoni i gjelbër/jeshile).

b) në pikën 9 përshkruani nga patentë shoferi i Juaj

- saktësisht të shënoni vendin e goditjes në mjet/ (pika 10)

- shënoni me X fushat (01-17) që ka të bëjë me aksidentin tuaj (pika 12) në fund t'i shënoni në total fusha të plotësuara me X (kryq).

- përpilo skicën e vendit të aksidentit të komunikacionit (pika 13)

3. Shënoni emrat dhe adresat e dëshmitarëve të mundshëm sidomos nëse mendimet e pjesëmarrësve të aksidentit nuk përputhen. Nëse policia ka prezantuar, sigurohuni që ta cekni emrin e stacionit policor.

4. Nënshkruani 'Raportin e aksidentit të komunikacionit', dhe pastaj jepjani shoferit tjetër për ta nënshkruar. Një kopje të raportit të nënshkruar dorëzojani shoferit tjetër pjesëmarrës në aksidentet, kopjen tjetër e mbani për vete.

• Pas kthimit në shtëpi

- Mos harroni ta cekni, ku dhe kur mund ta bëjnë shikimin dhe vlerësimin e dëmtimit të mjetit tuaj nga ana e ekspertëve.

- Në asnjë rrethanë nuk duhet të ndryshoni ndonjë gjë në pjesën e parë të raportit lidhur me aksidentin.

- Formën e raportit sa më shpejt të jetë e mundur ta paraqitni në kompaninë kompetente të sigurimit.

• Rastet të veçanta

- Nëse pjesëmarrësi tjetër në aksident ka të njëjtën formë që është miratuar nga Komiteti Evropian i Sigurimeve (C. E.A.) apo në një gjuhë të huaj, mbani në mend se format janë identike. Përmbajtjen në këtë formular, mund ta kuptoni duke e krahasuar me tekstin e formës suaj. Prandaj, çështjet janë të evidentuara me numra rendorë.

- Nëse aksidentin e komunikacionit e ka shkaktuar shoferi i mjetit me targa të huaja të regjistrimit, i dëmtuari duhet të kërkojë një kopje të kartonit të gjelbër, gjegjësisht të marrë një kopje nëse shoferi nuk ka kopje (kjo veçanërisht është e rëndësishme në rastin e mjeteve me targa nga vendet jashtë zonës së BE-së dhe Zvicër).